



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: Engin Beyoglu B.I

Emri Tregtar: Kent FM Radyosu

NUI: 810479475

Pronari: Engin BEYOGLU

OSHMA: Radio Kent FM

Adresa: Rr/Bajram Kelmendi,

Blloku A, Lokali 6/1, Prishtinë

Emri i Biznesit: "Klan Kosova" SH.P.K.

NUI: 810795297

Pronari: KGO Media Investments Holding SH.P.K.

NUI: 811575804

Pronari: KGO Media Investments DOOEL, Shkup


Pronari: Kushtrim GOJANI

Adresa: Rr/ Zona Industriale, ish Fabrika

Amortizatorëve Prishtinë

VENDIM

për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës të Radio Kent FM, ndryshim të emrit të Radio Klan Kosova FM si dhe ndryshim të skemës programore, me seli në komunën e Prishtinës



Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Kent FM është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim regional, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësorë të programeve të radios, me seli në komunën e Prishtinës. KPM, me vendimin e datës 17 janar 2017, ka bërë ripërtëritjen e licencës së Radio Kent FM për një afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Më datën 22 tetor 2021, Radio Kent FM ka dorëzuar në Zyrën Ekzekutive të KPM-së një kërkesë, përmes së cilës ka kërkuar miratim për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Kent FM nga biznesi individual Engin Beyoglu B.I., emri tregtar Kent Fm Radyosu, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810479475 dhe me pronar z. Engin Beyoglu tek biznesi Klan Kosova SH.P.K., me Numër Unik Identifikues - 810795297, me pronar personin juridik KGO Media Investments Holding SH.P.K. me Numër Unik Identifikues – 811575804, ndërsa ky biznes me pronar si person juridik KGO Media Investments DOOEL, EMBS – 7115326, me seli në Shkup dhe me personin fizik si pronar z. Kushtrim Gojani.

4. Gjithashtu, me anë të së njëjtës kërkesë, nga kandidati për pronar të ri, është kërkuar aprovimin i KPM-së edhe për ndryshimin e emrit nga Radio Kent FM në Radio Klan Kosova FM si dhe ndryshimin e skemës programore.


Arsyetim

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
8. Në kërkesën për ndryshimin e pronësisë, pronari aktual i Radio Kent FM ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim janë vështirësitë financiare të shkaktuara nga situata me pandeminë Covid 19, ngase se me fillimin e pandemisë bizneset i kanë ndalur reklamat.
9. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të Radio Kent FM (kandidati), përmes një deklarate me shkrim, ka shprehur gatishmëri që ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun ta bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
10. Komisioni konstaton se, kandidati përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka planifikuar zhvillimin e Radio Kent FM përmes rritjes së cilësisë së programeve, transmetim të programeve për të gjitha grupet e moshave të shoqërisë, angazhimin e stafit profesional dhe të kualifikuar si dhe investime në teknologjinë më të re, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare mbi shkallën dhe burimin e financimit.
11. Komisioni konstaton se Radio Kent FM ka shlyer pjesën më madhe të obligimeve financiare, për lëndët e proceduara tek përmbartuesi privat, ndërsa ka një lëndë (të hapur) të proceduar në gjykatë lidhur me borxhin ndaj tarifës vjetore të licencës, për vitin 2013 si dhe ka një gjobë të shqiptuar në korrik të vitit 2021, në vlerë prej njëmijë (1,000.00) eurove.
12. Komisioni konstaton se, lidhur me obligimet e mbetura financiare të Radio Kent FM të cekura më lartë, pronari aktual përmes një deklarate me shkrim është zotuar se mbetet prapa obligimeve financiare të radios, gjithashtu kandidati për pronar të ri të Radio Kent FM, po ashtu përmes një deklarate me shkrim është zotuar se qëndron në çdo kohë prapa çfarëdo obligimeve financiare të Radio Kent FM, obligimeve të tanishme apo të atyre të cilat mund të paraqitën në të ardhmen si obligime financiare të pashlyera ndaj KPM-së.

13. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare, angazhimit e stafit profesional zotimet për rritjen e cilësisë dhe llojeve të programeve si dhe investimeve në teknologji të re të transmetimit, si dhe duke pasur parasysh që kjo radio kohëve të fundit ka pasur probleme me transmetim, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Kent FM është në interes të publikut.
14. Lidhur me kërkesën për ndryshimin e emrit nga Radio Kent FM në Radio Klan Kosova FM, Komisioni konstaton se emri i propozuar për ndryshim nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e të licencuarve të KPM-së dhe si i tillë, nuk do të paraqesë pengesa apo konfuzion tek dëgjuesit gjatë transmetimit, prandaj emri i propozuar është i pranueshëm për ndryshim.
15. Komisioni konstaton se kandidati për pronarë të ri, gjithashtu ka bërë kërkesë për ndryshimin e skemës programore.
16. Komisioni vlerëson se, kërkesa për ndryshim të pronësisë dhe emrit dhe skemës programore të Radio Kent FM është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

17. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 16 nëntor 2021, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Kent FM nga biznesi individual Engin Beyoglu B.I., emri tregtar Kent FM Radyosu, me Numër Unik Identifikues (NUI) 810479475 dhe me pronar z. Engin Beyoglu tek biznesi Klan Kosova SH.P.K., me Numër Unik Identifikues - 810795297, me pronar personin juridik KGO Media Investments Holding SH.P.K. me Numër Unik Identifikues – 811575804, ndërsa ky biznes me pronarin si person juridik KGO Media Investments DOOEL, EMBS – 7115326, me seli në Shkup dhe me personin fizik si pronar z. Kushtrim Gojani.
18. Me anë të këtij vendimi të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Radio Kent FM barten te pronari i ri.
19. Komisioni vendos që të miratojë edhe kërkesën për ndryshimin e emrit të Radio Kent FM në **Radio Klan Kosova FM** si dhe ndryshimin e skemës programore, sipas kërkesës së kandidatit.
20. Përveç ndryshimeve të cekura më lartë në këtë rekomandim nuk do të ketë ndryshime në pjesët e Licencës si: Pjesës II – Parametrave Teknik dhe Pjesës IV – Zonës së Mbulimit.
21. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



25.11.2021
datë